

që nëpërmjet Programit “Një OKB” ta forcojmë më tej këtë rol të Agjencive të OKB duke rritur njëkohësisht dhe kontributet financiare. Fokusimi në fushat prioritare dhe në përputhje me prioritetet kombëtare do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve konkrete të objektivave të strategjive sketoriale, ndërsektoriale si dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Procesi i përzgjedhjes së projekteve prioritare për t’u financuar nën buxhetin e Programit “Një OKB” është një aspekt tjetër i rëndësishëm i cili do të përmirësohet më tej duke siguruar në të njëjtën kohë edhe transparencën e plotë të tij. Kjo do të arrihet përmes konsultimeve të ngushta, me Koordinatorin e Përhershëm dhe Komitetin e Përbashkët Ekzekutiv bazuar në kriteret tashmë të përcaktuara të shpërndarjes së burimeve.

Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet cilësisë së zbatimit të programeve dhe projekteve nën programin “Një OKB”. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt do të luajnë indikatorët për matjen dhe monitorimin e cilësisë së mbështetjes së programit të përfshira në mënyrë të detajuar në Dokumentin e Programit “Një OKB”. Nga ana tjetër ne do të sigurojmë përfshirjen e plotë të Ministrive të Linjës dhe Institucioneve të tjera shtetërore në zbatimin e këtyre projekteve.

Harmonizimi i burimeve financiare të donatorëve me ato të Programit Buxhetor Afatmesëm që Qeveria Shqiptare miraton çdo vit si dhe sigurimi i koherencës së plotë në financimin e projekteve prioritare nga donatorë të ndryshëm mbeten sfidat kryesore në kuadër të Programit të Qeverisë Shqiptare dhe të Deklaratës së Parisit.

Gjithashtu ne e konsiderojmë si një aspekt shumë të rëndësishëm rritjen e rolit të Koordinatorit të Përhershëm të OKB në zbatimin e Programit “Një OKB” si dhe në negociimin e këtij Programi me Qeverinë Shqiptare në përputhje me objektivat e tij por njëkohësisht duke respektuar rolin dhe kontributin e secilës Agjencie të OKB.

Për të lehtësuar funksionimin e strukturave të Programit “Një OKB” Qeveria Shqiptare që në fillimet e tij ka marrë vendimin për ti ofruar një ndërtesë të posaçme dhe procedurat për marrjen e saj janë në vazhdim.

Së fundi më lejoni të theksoj se zbatimi i Programit “Një OKB” është ende në fillimet e tij. Për këtë qëllim gjatë vitit të parë të zbatimit të kësaj iniciative ne bashkarisht do të kemi mundësinë e vlerësimit të ecurisë së tij si dhe përcaktimin e drejtimeve të mundshme për përmirësim. Bashkëpunimi ynë do të bazohet në eksperiencën tepër pozitive dhe të frytshme që patëm në hartimin e këtij programi dhe në identifikimin e prioriteteve të tij nëpërmjet një dialogu tepër konstruktiv me Koordinatorin e Përhershëm si dhe me Agjencitë e tjera të OKB.

Duke ju falenderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin,

Sinqerisht,

GAZMEND OKETA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Për dizeni: Zj. Gülden Türköz-Cosslett
Koordinatore e Përhershme e OKB
Tiranë, Shqipëri

